



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Komisioni për Buxhet dhe Financa**

**Legjislatura e III-të**

**Nr. 58/09**

**Prishtinë, më 24.07.2009, ora 9:00**

**Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203**

**PROCESVERBAL**  
**nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa**

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: **Gani Koci, Kosara Nikolić, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Haki Shatri, Müfera Şinik dhe Armend Zemaj, Riza Smaka dhe Hajdin Abazi, dhe Shkumbin Demaliaj.**

Anëtarët jo të pranishëm të Komisionit: **Naser Osmani dhe Besa Gaxherri.**

Nga stafi mbështetës i Komisionit: **Natasha Prica-Tisma, Vilson Ukaj, Dashurie Canolli, Fatmire Vojvoda (praktikante), Gazmend Avdyli (praktikant).**

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: **Ahmet Shala Ministër i MEF-it, Agim Krasniqi Drejtor i Departamentit të Buxhetit –MEF, Teki Shala nga NDI, monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.**

**Kryesues: Gani Koci, Kryetar i Komisionit.**

**Rendi i ditës:**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. 15.07.2009;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009**  
**I ftuar: Ministri për Ekonomi dhe Financa**
- 4. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës nr .03/2555/DO-1598 dt.20.07.2009 me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr .03-P-142/k të dt. 21.07.2009 për ratifikimin e anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Grupin e Bankës Botërore;**
- 5. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës nr. 03/2556/DO-1599 dt.20.07.2009 me Përfundimin e Kryesisë së Kuvendit nr.03-P-146/k të dt. 21.07.2009 për ratifikimin e**

**Marrëveshjes për nxitjen të investimeve ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës;**

## **6. Të ndryshme.**

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

### **2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja dt. dt. 15.07.2009**

**Kryesuesi**, konstatoi se procesverbali nga mbledhja e kaluar dt. 15.07.2009, miratohet pa vërejtje.

### **3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009**

**Haki Shatri**, theksoi se jemi të njohur me faktin se Qeveria mund të menaxhojë me të hyrat nga dividendat e PTK-së, por vetëm duke përfillur procedurën ligjore, që do të thotë se duhet paraprakisht marrja e vendimit të bordit të PTK-së. Kërkesa e grupit parlamentar të AAK-së, është që mjetet nga dividendat të futen si të hyrat buxhetore në një pozicion të veçantë dhe se ato mund të destinohen në ndërtimin e një projekti kapital siç është rasti autostradës “Prishtinë-Tiranë”. Kërkesa tjetër ka të bëjë zvogëlimin e subvencioneve dhe transfereve për importimin e energjisë. Si dhe kërkesa e tretë, që të gjitha projektet e papërgatitura sipas PIP kodit, të heqen nga buxheti i rishikuar. U interesua të dinte edhe për përshkrimin “fondi për kuadrat”.

**Kryesuesi**, theksoi se dividendin e menaxhon Qeveria dhe se duke ditur që nuk do të shpenzohen këtë vit, ato të mbesin pjesë e buxhetit të rishikuar dhe në vitin e ardhshëm do mund të vendoset për përdorimin e tyre, duke respektuar procedurat ligjore. Më pas njoftoi se kemi disa kërkesa që kanë të bëjnë me buxhetin e rishikuar. Një kërkesë nga grupi 7+ për ndarjen e mjeteve për shkollën “Motrat Qiriazi” në Prizren, për të cilën me rastin e miratimit të buxhetit janë ndarë 100.000€ ndërsa tani nuk figurojnë këto mjete.

**Armend Zemaj**, prezantoi disa kërkesa të grupit parlamentar të LDK-së. Njëra kërkesë kishte të bënte me ndërtimin e shkollës së mesme në Podujevë, tjetra kërkesë për ndërtimin e shkollës fillore në Podujevë, pastaj kërkesa për rikonstruimin e rrugës Podujevë-Ruglicë, dhe kërkesa për transferin e mjeteve në Spitalin rajonal në Gjilan “Objektin e ri të Administratës” i cili figuron si projekt por mungojnë mjetet. Në vazhdim propozoi një kërkesë për realizimin e projektit “Salla sportive në Strelcë të Epërm - Deçan” në shumën prej 150,000€ për të cilin ekziston projekti dhe shkolla ka nevojë shumë për atë.

**Shkumbin Demaliaj**, sa i përket kërkesës për ndërtimin e sallës sportive në Strelcë të Epërm – Deçan, theksoi se projekti nuk ekziston dhe mjetet mund të mbesin suficit. Nuk është e ditur që Ministria e Arsimit dhe komuna kanë bërë “Memorandum Mirëkuptimi”. Prandaj propozoi që të ndahen 200.000 € për ndërtimin e Sallës sportive në Deçan.

**Agim Krasniqi**, sa i përket pyetje për “fondi për kuadrat” ka të bëjë me mjetet që do të shkojnë për përmisimin e kushteve të stafi civil, që kanë përgatitje nga universitetet jashtë vendit.

**Safete Hadërgjonaj**, theksoi se projekti për “sallën sportive në Strelcë” është i arsyeshëm. Dhe në vazhdim propozoi që për këtë projekt të ndahen 100.000 € ndërsa 50.000€ tjera për ndërtimin e “sallës sportive në Rastovicë – Deçan”.

Kërkesa u përkrah nga komisioni.

**Kosara Nikolić**, theksoi se shuma prej 5.000.000 për projektin „kthimi individual“ e paraparë në Ministrinë për Komunitet dhe Kthim nuk ekziston.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se me nëntë vota Për, një Kundër (z. Haki Shatri) dhe asnjë Abstenim, Komisioni nxori këtë:

### **Raport me Rekomandime**

- I. Miratohen Projektligjin për ndryshimin e Ligjit nr. 03/L105 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009 me amendamentet e propozuara.
- II. Raporti me amendamente procedohet për miratim në Kuvend.

Pika 4 dhe 5 të rendit të ditës nuk u shqyrtuan nga komisioni, me arsyetimin se pika e 4 ishte diskutuar dhe aprovuar paraprakisht në Kuvend, ndërsa për pikën e 5 ndërkohë ka ardhur një Informatë nga Zyra e Kryeministrit se çështja e Marrëveshjeve për nxitjen e investimeve ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe qeverive të vendeve tjera, iu dërgohet Kuvendit vetëm për njoftim dhe jo për shqyrtim dhe aprovim. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës ratifikimin e kësaj marrëveshje e bënë Presidenti i Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

**Përgatitur nga**

**Njësia për mbështetjen e Komisionit**

**Kryesuesi i Komisionit,**

\_\_\_\_\_  
**Gani KOCI**